

NGA AUTORI I "AJO E ERRËTA"

# ENKELEJD LAMAJ



# GJITHCKA QË KË

THRILLER



# GJITHÇKA QË KE

Roman

**Enkelejd Lamaj**

THRILLER

**KY NUK ËSHTË VERSIONI I PLOTË**

Kjo provë ofrohet vetëm për qëllim leximi paraprak.

© 2021, **Enkelejd Lamaj**

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë prej kapitujve të librit në këtë variant elektronik ose pjesë e tyre, nuk mund të riprodhohet ose të përdoret në asnjë lloj mënyre apo forme, pa lejen e shprehur me shkrim, përveç përdorimit të civateve të shkurtra.

Ky format elektronik është i autorizuar vetëm për kënaqësinë tuaj personale.

Ky format nuk mund të tregtohet.

Ju faleminderit që respektuat punën e palodhur të autorit dhe të shtëpisë botuese.

Për më shumë

**Zbuloni praninë zyrtare në WEB:**

**Enkelejd Lamaj**

**Arka e Noes Editions**

[WEB](#)  
[INSTAGRAM](#)  
[FACEBOOK](#)  
[E-MAIL](#)

[INSTAGRAM](#)  
[FACEBOOK](#)  
[E-MAIL](#)

**GJITHÇKA QË KE**

*Gjithçka që ke.*

*E dua.*

*Mund të mos jetë shumë, por për dikë që nuk ka asgjë, është më shumë se gjithçka.*

*Si ndihesh, kur hap sytë në mëngjes dhe shikon ndriçimin e ditës? A nuk të duket sikur sapo ke ardhur sërish në jetë? E, bashkë me ty, edhe gjithçka tjetër rreth e përqark teje? Gjithçka që ke?*

*E ke pyetur ndonjëherë veten se çfarë ndodh me ty, kur nuk je zgjuar? A nuk të ngjason sikur, gjatë kohës që je me sy të mbyllur, ke vdekur? Koha ecën, sigurisht, kështu të thonë, por çdo gjë e jotja ndalon, bashkë me ty. Dhe pa mendo pak: në qoftë se nuk i hap më sytë, çfarë ndodh me gjithçka që ke?*

*Vdes, ja se çfarë ndodh! Gjithçka që ke, vdes.*

*Për ty, sigurisht. Por jo për tjetërkënd.*

*Tani imagjino dikë që nuk i ka hapur dot sytë kurrë. Imagjino dikë që nuk ka ekzistuar asnjëherë, përveçse nëpër ëndrra dhe imagjinata. Që ka qenë thjesht një dëshirë, lindur e rritur atje, në vendin diku midis, ku jetojnë e vdesin të gjitha dëshirat. Imagjinoje tani, këtë dikë, sikur i hap sytë për herë të parë.*

*Sikur sheh ndriçimin e ditës.*

*Për herë të parë.*

*Çfarë mendon se ndodh me gjithçka që nuk ka pasur deri atë çast?*

*Dhe me gjithçka që dëshiron prej atij çasti?*

*Me gjithçka që ke?*

*Vihet nga asgjëja për të përfunduar sërish në asgjë. Por rrugës, dëshirohet gjithmonë gjithçka.*

*Gjithçka që ke.*



*(Mos u mërzit, shpirt! E rëndësishme është që ti je mirë! Do ta kalojmë. Do ta provojmë përsëri.)*

Ai do t'ia thoshte këto fjalë, por në të vërtetë do të nënkuptonte fjalë të tjera. Ajo do ta kuptonte. Kur të dilnin prej spitalit dhe të shkonin në shtëpi, ajo do ta kuptonte.

Geraldi nuk do ta shikonte më në sy.

Geraldi do t'i fliste gjithnjë e më pak.

Geraldi do t'i tregonte, gjithnjë e më pak, për ditët e tij të punës.

Geraldi do t'i fliste me fjalë të vogla. Do t'i përgjigjej me fjalë njerërore.

Geraldi nuk do ta dëgjonte.

Dhe ajo do ta linte punën si drejtoreshë e Drejtorisë Ekonomike. Do të bashkohej me shoqet e saj të ngushta dhe do të krijonin shoqërinë e tyre. Do t'i përkushtohej punës. Do të punonte me orë të zgjatura, edhe atëherë kur puna të kërkonte shumë më pak orë për t'u përfunduar.

Por edhe Geraldi do të bënte njësoj. Madje edhe më shumë. Ai do të kryente shërbime të gjata jashtë qytetit. Do të mungonte gjithnjë e më shpesh. Shtëpia e tyre do të kthehej në një hotel.

Dhe në ato pak herë, kur ata të gjendeshin në të njëjtën kohë, në shtëpinë-hotel, ajo do të dëgjonte

*(Mos u mërzit, shpirt! E rëndësishme është që ti je mirë! Do ta kalojmë. Do ta provojmë përsëri.)*

fjalët e vërteta, që pati nënkuptuar burri i saj, atë mëngjes, në maternitet. Në fillim si pëshpëritje, të nëpërdhëmbura si një e folur me vete, por pastaj me zë më të lartë, gjithnjë e më shumë me zë më të lartë.

Derisa ajo të mos mbante më.

Derisa edhe ai të mos mbante më.

Derisa kupat e jetës së tyre të tejmbusheshin dhe derdreshin përsëri. E përsëri. E përsëri.

*(Ti e kishe fajin!)*

*(Ti dhe vetëm ti!)*

*(Pijanece e dreqit!)*

*(Je një hiç!)*

*(Je një asgjë e pashpirt!)*

*(Je një vrasëse!)*

*(Jetë-shkatërruese!)*

E përsëri. E përsëri. E përsëri. Deri ditën kur ajo të shkonte në shtëpinë-hotel dhe të gjente dollapët e boshatisur dhe shënimin mbi tavolinë.

Do të ndaheshin, më në fund. Për të mos u takuar më kurrë.

Vetëm se të gjitha këto kishin ndodhur një herë. Nuk mund të ndodhnin përsëri. Ishte e pamundur. Ajo e kishte kaluar një herë atë ferr.

Po a mund të kalohet ferri? A mund të shpëtohet prej tij? Apo një herë që hyn në të, qëndron aty, përgjithmonë, duke e përjetuar gjithnjë e gjithnjë e gjithnjë, pafundësisht?

Ajo përpëliti sytë.

Një dallgë drite iu derdh në mes të kokës dhe kujtimet e ferrit iu shpërndanë, si një grusht tymi i shpartalluar nga një shkullm ere. Në vendin e lënë bosh, ajo dalloi siluetën e një kujtimi tjetër. Më të freskët e më të gjallë.

Ajo e ndoqi kujtimin me shpejtësi, e kapi dhe, kur vështroi brenda saj, u gjend

*(duke ecur në një rrugë gjysmë të errët, me jakën e xhaketës lart, shallin e shtrënguar mirë rreth qafës dhe duart thellë në xhepa, teksa era e ashpër i godet fytyrën. Një makinë i ndalon pranë këmbëve dhe një zë e pyet nëse ka nevojë për një taksi që ta çojë diku. Ajo nuk i kthen përgjigje. Qesh dhe vijon rrugën duke u kalamendur. Çanta e vogël që i ka blerë Ertriti për ditëlindje i hidhet para e pastaj i përplasat pas kofshës. Është)*

krejtësisht e dehur. Pothuajse si gjithë herët e tjera. Të paktën me aq sa mbante mend, ajo nuk ishte

*(Ti dhe vetëm ti! Pijanece e dreqit!)*

hera e parë, por në asnjë prej herëve të kaluara nuk

*(Je një hiç!)*

kishte

*(Je një asgjë!)*

bërë

*(Vrasëse!)*

ndonjë

*(Jetë-shkatërruese!)*

idiotësi.

Ja një zgjim tjetër! Ja një ditë tjetër! Koka i dhemb dhe as një, as dy, as tre Advilë nuk ia qetësojnë. Sa kohë e kaluar në shtrat! Dhe sa të vjella! Oh, sa shumë të vjella!

Po atë herë?

Edhe atë here kishte vjellë. Ja, përsëri

*(e mbështetur mbas një peme, duke nxjerrë ca copa ushqimesh të patretura e plot ngjyra. Pyet veten se çfarë dreqin ka ngrënë. Në ato moment nuk e mban mend. Në atë moment)*

*(e mbështetur mbas një peme, duke nxjerrë ca copa ushqimesh të patretura e plot ngjyra. Pyet veten se çfarë dreqin ka ngrënë. Në ato moment nuk e mban mend. Në atë moment)*

imazhet e kujtimeve vinin dhe iknin si dritat e një blicci që shkrepet pa pushim dhe ja tani

*(duke u mbajtur pas murit të shkallëve. E përthyer përsëri në dysh. Përsëri duke vjellë. Por kësaj here nuk ka më asgjë se çfarë të nxjerrë. Vetëm ca fije uji)*

dhe

*(e mbështetur pas murit të korridorit)*

dhe

*(e shtrirë në divan)*

dhe

(*është... është... është...*)

Në errësirën e saj, dhembja i theri përgjatë të dy duarve. Lëvizi gishtat e dorës së majtë dhe dhembja i gjarpëroi gjer në tru. Lëvizi gishtat e dorës së djathtë dhe dhembja i shpoi sytë.

Duke skërmitur dhëmbët, Adelina Hoxhaj ia doli ta ngrinte dorën para syve. Një lëmsh iu mblodh në fyt, kur pa se parakrahu i saj mbështillej nga një shtresë e zezë. Bërtiti. Por vetëm në mendje, se zëri nuk i doli.

Shtresa e zezë, përreth parakrahut, filloi të shpërbëhej.

Jo, nuk filloi të *shpërbëhej*. Filloi të *ngjitej* në ajër. Pak e pak.

Shtresa që i mbështillte parakrahun, ishte një tufë fluturash të zeza, që po ngriheshin në fluturim, njëra pas tjetrës.

Ajo bërtiti. Kësaj here me shumë zë. Dera e dhomës u hap me vrull dhe dritat u ndezën. Errësira u tërhoq nëpër qoshe. Një grua iu afrua te koka me nxitim, i mori dorën që kishte ngritur para syve dhe, me shumë delikatesë, ia shtriu sërish poshtë mbulesës së krevatit.

*Ja ku qenkam! Në një krevat.*

- Ela, o Ela! - thirri gruaja në telefonin që mbante në vesh. - Lajmëro pak doktor Naimin. Thuaji që treqind e katra sapo u përmend.

*Treqind e katra.* Ishte ajo? Thjesht një numër domethënës? Po treqind e tre të tjerët ku ishin? Ku ndodhej?

*Je thjesht në një dhomë spitali. Treqind e katër është numri i dhomës, jo numri yt.*

Gruaja përfundoi telefonatën dhe futi celularin në xhepin e përparësës së bardhë. Në të njëjtin çast, te pragu i derës u shfaq fytyra e një burri dhe pastaj, edhe trupi i tij, brenda një uniforme policie. Ai, pasi i hodhi një vështrim të padeshifrueshëm, nxori një telefon të vogël prej xhepit dhe doli sërish jashtë.

Ajo tentoi të lëvizte, por muskujt protestuan dhe dhembja e përshkoi kokë e këmbë.

- Jo, zemër, jo. Mos lëviz! - Infermierja i vuri dorën në ballë. Ajo ishte e ftohtë dhe e lagësht. - Ja, sa të vijë doktori. Por mos u mundo të lëvizësh.

- Pse jam këtu? - pyeti Adelina, duke hedhur vështrimin rreth e përqark.

Për një moment, vështrimi iu turbullua nga një

(tufë fluturash të zeza)

shkulm mjegulle e hirtë dhe ajo puliti qepallat, derisa mjegulla u shpërnda dhe ajo mundi të shihte përsëri. Sipër kokës së saj, drita e dhomës regëtiu dhe papritur, ajo e pa veten të shtrirë sa gjatë e gjerë në çimento, me celularin te veshi dhe

*Pse?*



dy njerëz me përparëse të bardha po e ngrinin dhe po e vendosin në një barelë dhe

Pse?

një tufë fluturash të zeza u ngritën fluturim para saj.

- Çfarë ka ndodhur? - belbëzoi.

- Ja, se tani vjen dhe doktori, zemër. Mos u shqetëso!

Gjithçka do të vejë mirë.

Pa mbaruar mirë fjalën, një burrë i vjetër hyri në fushëpamjen e saj.

- Përshëndetje! Unë jam doktor Naimi. - Pa e zgjatur më shumë, ai i vuri dorën në ballë. Ndryshe nga ajo e infermieres, dora e tij ishte e ngrohtë, por e ashpër. - Si ndihesh?

- Pse jam këtu?

Doktor Naimi i hodhi një vështrim të shpejtë infermieres. - Nuk e mban mend?

Adelina lëvizi kokën në shenjë mohimi dhe doktori i hodhi një vështrim tjetër infermieres. Pastaj mori kartelën mjekësore prej tavolinës pranë krevatit dhe e hapi ta lexonte.

- Po emrin e mban mend?

Ajo pohoi me kokë. - Adelina Hoxhaj. Por nuk e di përse jam këtu. Unë... Ti e di!

- Data e lindjes? Emrat e prindërve? I mban mend?

Unë i di?

Me vërtetë i di?

Adelina lëvizi sërish kokën për të pohuar. Po, i mbante mend. Lindur më 24 maj 1983, në Lushnjë. Emri i babait: Rudolf. Emri i mamasë: Anjeza. Dhe shtoi: Mamaja ka vdekur ditën që e solli në jetë, ajo nuk e ka njohur kurrë, babai jeton në Lushnjë, kurse ajo në Tiranë.

Ia tha të gjitha këto dhe doktor Naimi i ballafaqoi me të dhënat e siguruara prej policisë dhe që qenë shkruar te kartela. Pastaj ai urdhëroi infermierën t'i rregullonte krevatin dhe ajo kaloi në anën tjetër të tij, ku shtypi një buton. Krevati u ngrit gjersa ajo u gjend e ulur dhe jo më e shtrirë.

Doktor Naimi vendosi kartelën mjekësore mbi tavolinë, pastaj e pa në sy. E pyeti edhe njëherë nëse vërtet nuk e mbante mend se pse qe aty dhe kur Adelina tundi kokën në shenjë mohimi, ai i tha, me qetësi:

- Mbrëmë ke tentuar të vrasësh veten.

Adelina zgurdulloi sytë. - Çfaaaarë?! - thirri dhe vetëm në atë çast morën kuptim kyçet e duarve të mbështjella me

(flutura të zeza)

fasha të bardha gjer në mes të parakrahut. Tani ato i pulsuan me forcë, a thua se nën fasha kishte

(flutura të zeza që përpëliten për të dalë jashtë)

zemrën.

Me ngadalë, Adelina nxori duart nga mbulesa e krevatit dhe i vendosi mbi prehër.

- Jo, s'ka m-mundësi! - belbëzoi dhe një tjetër imazh e verboi. Ajo mbylli sytë për të mos e parë, por ai filloi t'i qartësohej edhe më shumë, si ato fotografitë e çastit kur i tund në ajër dhe dalëngadalë, dritëhijet e imazhit u kthyen në një figurë të qartë dhe të palëvizshme, plot ngjyra dhe jetë.

Një dorë që shtrëngonte një thikë.

Dora e saj.

*Jo! Jooo! Jooooooooo!*

Kjo është dora jote!

Jo, kjo është dora jote!

- Je shumë me fat që munde t'i telefonosh vetë policisë.

Adelina u mat të pyeste se kur, me saktësi kishte ndodhur, por burri i veshur si polic u shfaq pas kurrizit të doktorit.

- A mund t'flas pak me vajzën? - pyeti, duke parë Adelinën.

Doktor Naimi tundi kokën në shenjë pohimi. - Por jo më shumë se dhjetë minuta.

- M'duhet vetëm pes, - ia ktheu tjetri, duke vënë buzën në gaz. - Mund t'rrish dhe vet, po të duash. Thjesht një formalitet kam.

Doktor Naimi qëndroi, kurse infermierja la dhomën me hapa të shpejtë, sikur mezi ta kishte pritur atë çast.

Formaliteti zgjati njëzet e pesë minuta. Burri i veshur me uniformë policie u prezantua si Dalan Rama, Specialist për Hetimin e Krimit në Komisarariatit e Policisë Nr.1 të Tiranës dhe Adelina përsëriti edhe një herë të dhënat që sapo i kishte thënë doktor Naimit, përfshi dhe faktin që nuk mbante mend asgjë nga ajo që kishte ndodhur. Gjithsesi, me kërkesë të tij, ajo i tregoi gjithçka që mbante mend nga nata e kaluar. Kishte qenë me dy shoqet e, njëkohësisht, ortaket e biznesit të saj, me të cilat njihej prej fakultetit. Kishin pirë te "Bar Komiteti", pranë ETC-së, pastaj Zamira kishte shkuar në shtëpi, kurse ajo dhe Vitjola kishin vijuar të pinin deri vonë në darkë. Sa vonë? Po deri rreth orës 23.30. Çfarë pinë? Ajo verë të kuqe, kurse Vitjola *Mojito*. Në fund, duke qenë se kishin pirë shumë, kishin marrë nga një taksì, secila. Kur kishte shkuar në shtëpi...

*Flutura të zeza.*

Errësirë.

Këtu fillonte pjesa kur ajo nuk mbante më mend asgjë.

Atëherë, Dalan Rama e pyeti nëse ndodhej në ndonjë lidhje dashurie. E martuar? E divorcuar? Adelina i tregoi gjithçka. Dikur kish qenë e martuar, por jo më. Me Gerald Ujkanin ishte ndarë para tri vjetëve. Kur, me saktësi?. Në tetor të vitit 2017. Jo, nuk kishte pas ndonjëherë probleme me të. As nuk ish in takuar më, madje. Po, ajo tani ndodhej në një lidhje tjetër dashurie. Dhe jo, as me të dashurin e tanishëm nuk kishte probleme. Ishte shumë e lumtur me Ertritit dhe ai ishte shumë i lumtur me të. Si e kishte mbiemrin Ertriti? Xhaka. Specialisti i kërkoi edhe numrin e celularit të tij, e mbajti shënim, pastaj e

pyeti për punën. Çfarë lloj biznesi kishte ajo dhe ortaket e saj?

Adelina ia tregoi. Emrin e shoqërisë së kontabilitetit, NIUS-in, të dhënat e plota të dy ortakeve të tjera të saj, emrat, numrat e tyre të telefonit, adresat ku banonin, si dhe adresën e saktë të vendndodhjes së shoqërisë.

Në fund, ai i kërkoi numrin e celularit dhe adresën e shtëpisë së saj. Kishte mundësi që ai, ose ndonjë koleg tjetër, ta merrte në telefon, ose t'i shkonte në shtëpi për ndonjë pyetje tjetër, por, nga mënyra se si ia tha, dukej qartë që askush nuk do të merrej më me të. Qe fiks siç kishte thënë ai në fillim: thjesht një formalitet.

Pas kësaj, Dalan Rama u kthye nga doktor Naimi dhe i kërkoi të rrinte pak vetëm me *pacienten*.

- Vetëm një minut gjë, - i tha. - Është një pyetje, që, me thënë t'drejtën, bën pjesë tek sekreti hetimor dhe... dhe m'duhet t'ia bëj privatisht.

Doktor Naimi i hodhi një vështrim Adelinaes, e cila nuk tha gjë.

- Dakord. Por, ju lutem, nuk duhet në asnjë mënyrë ta stresoni.

- Ta premtoj, doktor, pacientja nuk do stresohet fare nga pyetja ime e fundit.

Dalan Rama u kthye nga Adelina, e cila vazhdonte të mendonte për fjalët "sekret hetimor" dhe ai, si t'ia kish lexuar mendjen, i shkeli syrin. Kur doktor Naimi la dhomën dhe mbylli derën pas vetes, ai iu afrua shtratit. Tani merrte frymë me vështirësi dhe fytyra i qe skuqur si një spec djegës. Me ngadalë, po hapte zinxhirin e xhupit.

- Jam shumë n'siklet, - foli me gjysmë zëri. - Unë... kjo nuk ka t'bëjë me asnjë sekret hetimor. Unë... mua thjesht m'duhet t'kërkoj një nder për shefin tim. N'fakt ai nuk është tamam shefi im, po është...

- "Vdekja e një gruaje tjetër" është ai?

Dalan Rama uli sytë te libri që nxori prej xhupit dhe pohoi me kokë. - Po, ai.

Adelina buzëqeshi.

- Para se t'vija ktu, - tha ai, - isha me drejtorin e Departamentit të Policisë Kriminale të Tiranës, Edmond Kalaja, që është njikosisht dhe xhaxhai i gruas sime. Kur e mori vesh se kush ishe dhe se unë do vija ktu për t'bërë procedurën, m'u lut që t'kërkoja një nder. - Dalan Rama rrotulloi librin në duar. - Vajza e tij ka ditëlindjen sot. Mbush shtatmet dhe është e marrosur pas librave të tu. E bleva rrugës këtë... nëse ka munci t'i bësh një autograf.

Adelina mori librin në dorë dhe e hapi te fleta e parë, që botuesi e kishte lënë bosh enkas për kësi rastesh. Sa do t'i thoshte që nuk kishte stilolaps, Dalan Rama i zgjati të tijin.

- Më thuaj diçka, - i tha Adelina, duke i marrë stilolapsin nga dora. - A do të dalë gjë emri im në televizor, apo në ndonjë prej portaleve online për këtë që... ndodhi? Do të doja që të mos dilte.

- Ta premtoj që jo, - ia ktheu Dalan Rama, pa hezituar.

- E sigurt që e ke tagrin për të bërë këtë premtim?

- Ta siguroj se po, - ia ktheu ai, duke qeshur. - Po dhe po s'e pata un, e ka Edmond Kalaja qin për qin.

Adelina Hoxhaj u mendua për një hop, pastaj tundi kokën në shenjë miratimi.

- Si e ka emrin vajza e Edmondit?

### 3

Kur Adelina Hoxhaj doli prej spitalit, e priti një Ertrit Xhaka i hutuar dhe krejt i nxirë në fytyrë. Për pak sa nuk ishte rrahur me rojën, që nuk e kishte lënë të ngjitej lart. Kur u përqaftuan dhe ai e puthi, Adelina vuri re se ai i kishte sytë e njomë.

Ertriti nuk i bëri asnjë pyetje dhe kjo e lehtësoi, sepse, e fundit gjë që donte të bënte në atë çast, ishte të tentonte të shpjegonte diçka, që as vetë nuk e dinte mirë se si kishte ndodhur.

Në makinë, Ertriti i tha se kishte njoftuar edhe Lejlën, e cila tani duhej të qe duke i pritur para pallatit. Adelina thjesht pohoi me kokë, pastaj mbuloi fytyrën me duar dhe u shkreh në vaj. Ertriti e përqafoi dhe e puthi në kokë. Rrugës për në shtëpinë e Adelinës, nuk folën. Dukej sikur askush prej tyre nuk po vendoste dot se çfarë emri t'i vinin asaj që kishte ndodhur.

Apartamenti i Adelinës ndodhej në katin e tretë të një pallati të vjetër në rrugën "14 Marsi", ngjitur me Kompleksin Sportiv "Ali Demi". Jetonte aty që prej kohës kur mbaroi shkollën e lartë. Në atë kohë, e kishte gjetur thjesht ngaqë ndodhej pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, ku sapo kishte filluar punë si specialiste në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse. Puna aty i zgjati vetëm nëntë muaj, megjithëkëtë, ajo nuk e ndërroi shtëpinë dhe vijoi ta paguante qiranë rregullisht. Pas vdekjes së të dy pronarëve, katër vite më parë, ajo madje ishte ofruar për ta blerë apartamentin, por djali i vetëm i Bekim dhe Sheqere Myslimit nuk kishte pranuar.

Te sheshi i vogël para pallatit, Ertriti ndaloi makinën përballë me qepenin e dyqanit të katit të parë, i cili nuk përdorej prej tre vitesh. Mirela Ademi, ose Lejla për shoqërinë, ishte duke bërë ecejake, para e mbrapa, nga njëri cep i sheshit te tjetri. Kur njohu makinën e Ertritit, u doli turravrap. Adelina nuk arriti të dilte mirë prej makinës se e gjeti veten në krahët e saj.

- A mund të më thuash se ç'a dreqin ishte kjo? - e pyeti, porsa e lëshoi nga përçafimi. - Je në terezi, apo jo? Çfarë të tha truri?

Në vend të përgjigjes, Adelina rراسi fytyrën në qafën e saj dhe rënkoj.

- Ej, shoqe, lëre të marrë pak frymë, - ndërhyri Ertriti, duke hedhur vështrimin rreth e përçark. - Ku e paske lënë makinën? - pyeti nëpër dhëmbë, pastaj shkundi supet dhe vështroi Lejlen. - Eja, ngjitemi lart më mirë.

Lejla pohoi me kokë, por gjithsesi, priti që Adelina të qetësohej, para se ta shkëpuste prej vetes e ta udhëhiqte drejt hyrjes së pallatit. Vetëm se Adelina nuk u qetësua. Me të filluar ngjitjen e shkallëve, zemra i rrahu me forcë. Një ngërç e kapi në stomak dhe asaj iu desh të mbahej, sa pas murit, sa pas shoqes.

*Po kthehem te vendi i krimit.*

(Kjo është dora jote!)

(Jo, kjo është dora jote!)

Përsëri ajo ndjesia sikur dikush tjetër i foli me zërin e saj brenda kokës. Një grusht gjilpërash e shpuan lehtë përgjatë shtyllës kurrizore dhe ajo ndali hapat dhe ktheu kokën për të parë nëse dikush i ishte afruar pas kurrizit.

- Çfarë është? - e pyeti Lejla, duke kthyer edhe ajo kokën pas.

Adelina rrudhi buzët, shtrëngoi krahun e shoqes dhe ngjiti shkallët, pa u përgjigjur. Kur mbërritën te sheshpushimi para derës së apartamentit të saj, koka i erdhi vërdallë dhe korridorin u ngushtua. Me dorën e lirë, masazhoi ballin. A e kishte gënjyer ajo inspektorin e krimeve, kur i kishte thënë se nuk mbante mend asgjë, që prej çastit që kishte shkuar në shtëpi? Adelina kërkoi edhe një herë në kujtimet e saj, por gjithçka që kishte të bënte me ato momente, qëndronte e mbështjellë nga një perde e dendur mjegulle.

Po pse atëherë vazhdonte ta kishte ndjesinë sikur e kishte gënjyer vërtet inspektorin e krimeve qëparë?

Teksa Ertriti hapte derën e apartamentit, Adelina nuk e dinte se si t'i përgjigjej asaj pyetje.

*Kam qenë e pirë, shumë e pirë, prandaj nuk e mbaj mend.*

Po sa e pirë kishte qenë, mbrëmë?

Përgjigjja i erdhi në formën e një sëmbimi, që i vërshoi si një baticë e ftohtë në të gjithë kokën dhe Adelina ndjeu trurin

dhe sytë që, sikur iu frynë përtej kapacitetit të kafkës, aq sa, për një çast, priti që ata t'i shpërthenin.

Nuk ishte hera e parë që ndihej ashtu.

*(Pijanece e dreqit!)*

*(Vrasëse!)*

*(Jetë-shkatërruese!)*

Ti e ke fajin! Sepse nuk dua.

Sepse nuk do të m'gjosh.

- Eja, zemër!

Ertriti shtyu derën dhe Lejla e shoqëroi brenda.

- Jo, më ço në kuzhinë, - i tha Adelina, kur pa që ajo iu drejtua dhomës së gjumit.

Ertriti shtyu derën e jashtme dhe u parapriu. Te pragu i derës së kuzhinës, ngriu në vend dhe çoi dorën te goja për të mos bërtitur. Lejlës iu desh ta qëllonte me majën e këmbës te thembra, që ai të lëvizte për t'u hapur rrugën.

Por edhe Lejla ngriu te pragu i derës dhe zgurdulloi sytë.

Kur Adelina hyri midis tyre, një dorë e akullt e shtrëngoi në fyt.

Dhoma e ndenjes ishte e kthyer përmbys, sikur aty të kish kaluar një uragan. Televizori ishte i përmbysur, copat e ekranit të thyer mbulonin një pjesë të tavolinës së mesit dhe njërin prej dy librave që mbante aty. Libri tjetër nuk dukej, por tek-tuk dukeshin fletët e tij, të shpërndara si gjethe të vdekura. Njëra prej dy perdeve ishte shkukur dhe hedhur mbi kolltukun tek. Divani tresh, që i njihte çdo formë të trupit, kishte lëvizur vendit, mbështetëset ishin hequr dhe flakur nëpër dhomë, së bashku me jastëkët shumëgjyresh. Njëri prej tyre - i kuqi - ishte grisur dhe puplat i dilnin jashtë, si të brendshme të copëtuara. Një tjetër kishte përfunduar në lavaman, te pjesa e kuzhinës, e cila nuk dukej më pak keq. Kishte ushqim të shpërndarë në të gjithë mikrovalën, dera e së cilës ishte e thyer, copa mbeturinash në të gjithë banakun a gatimit dhe një lëng i trashë, i pangjyrë, lyente raftet gjithandej. Sirtarët ishin thujse të gjithë të hequr dhe brenditë e tyre ishin nxjerrë e shpërndarë kudo, rreth e përçark. Një prej kanatave të dollapit, poshtë lavamanit, ishte e thyer dhe varej mënjanë, si një krah i spërdredhur.

Por ajo që mbërtheu vështrimin e Adelinës, ishte tryeza e ngrënies. Ajo, e cila mbarte aromat e sa e sa vakteve dhe kujtimet e sa e sa emocioneve dhe gjendjeve shpirtërore të saj, tani dergjej, si një trup i plagosur, me njëren këmbë të thyer dhe e mbushur, ngado, plot me njolla gjaku. Vazoja e frutave, që mbante përsipër, kishte rënë dhe ishte thyer. Frutat ishin shpërndarë, si ushtarë të vdekur në luftë. Një prej tyre, një avokado, vetëm pak më e madhe se grushti i saj, që kush e di se sa rrugë kish bërë, se sa kamionë e duar kish ndërruar vetëm e vetëm për të mbërritur gjer në tryezën e saj, tani dergjej pa

jetë në një pellg gjaku të tharë e të fortë, vetëm dy hapa larg. Dhe teksa Adelina e kuptoi se nuk do të hante më kurrë avokado në jetën e saj, vështrimi i rrëshqiti përtej pellgut të tharë, gjakun e të cilit dikush e kishte përdorur për të shkruar tri fjalë:

### **GJITHÇKA QË KE**

Adelina Hoxhaj ra në terr.

### **TRE MUAJ MË VONË**

#### **4**

Trupi i Luljeta Likës u zbulua në orën dhjetë e pesë, të paradites.

E shtuna ishte një prej ditëve që gratë e pinin kafën poshtë, te lokali i Sanies, ngjitur me hyrjen e pallatit. Në orën shtatë e njëzet, Bardha Mazreku u vesh dhe zbriti shkallët me ngadalë. Atë mëngjes, për fat të mirë, nuk ndiente shumë dhembje nga mesi, megjithëkëtë, iu deshën gati pesë minuta për të zbritur nga kati i katërt. Kur mbërriti te lokali, Sanie Malaj ishte ulur në qoshen e tyre të zakonshme.

Bardha u ul te karrigia e saj dhe pritën gjer të vinte dhe Luljeta. Zakoni e donte që kafën ta pinin kur të ishin të tria bashkë.

Por Luljeta Lika nuk erdhi. As për të pirë kafën bashkë me shoqet e saj te vjetra, as për gjë tjetër.

Në fillim gratë kujtuan se mos asaj i kishte ardhur djali nga Berati. Ai punonte si agjent shitje për një linjë prodhimi dyshekësh dhe pothuajse tërë javën e kalonte rrugëve. Kur ndodhej në Tiranë, ndalonte gjithmonë të takonte të ëmën, kurse fundjavave, zakonisht vinte së bashku me familjen, gruan dhe dy djemtë. Ato ishin të vetmet raste kur Luljeta dilte vonë nga shtëpia.

Në orën tetë, Bardha i telefonoi Luljetës, por numri i saj ishte i fikur. Në orën tetë e tridhjetë e provoi përsëri dhe në orën nëntë, kur u kthye në shtëpi, edhe një herë tjetër. Asgjë. Telefoni i shoqes vazhdonte të ishte i fikur.

Në orën nëntë e një çerek, Bardha i telefonoi Sanijes. Sanija, e cila tashmë kishte filluar punën pas banakut, e pa thirrjen e humbur në ora nëntë e njëzet e një. Kur i telefonoi mbrapsht dhe

dëgjoi merakun e shoqes, u shqetësua edhe vetë. Dhe Bardha kishte të drejtë: dikush duhej ta kontrollonte shoqen e tyre.

Në nëntë e njëzet e pesë minuta, Sanija u ngjit në katin e tretë të pallatit përballë dhe trokiti në derën e apartamentit të Luljetës. Pesë minuta më vonë, në sheshpushimin e katit, dolën dhe dy fqinjët e Luljetës. Pasi trokitën dhe thirrën për gati dhjetë minuta të tjera, Sanija zbriti turravrap dhe detyroi të shoqin t'i telefononte policisë.

Kur më vonë e pyetën përse ishte shqetësuar aq shumë, Sanije Malaj u shpreh se nuk e dinte, thjesht kishte pasur një si parandjenjë të keqe.

Një patrullë policie ndaloi në lagje në orën orën nëntë e pesëdhjetë. Punonjësit e policisë, pasi vlerësuan situatën dhe morën të gjithë informacionin e duhur në lidhje me gruan që jetonte aty, si fillim gjetën të dhënat dhe i telefonuan djalit të saj, Sajmir Likës. Sajmiri u bëri me dije se herën e fundit që kishte folur me të ëmën kishte qenë ora nëntë e darkës së djeshme. Atë mëngjes, edhe ai kishte tentuar disa herë të fliste në telefon me të, por celulari i saj i dilte i fikur. Herën e fundit e kishte provuar vetëm çerek ore para telefonatës së policisë. Nuk i kishte shkuar mendja për keq, sepse mamaja e tij e kishte zakon që ta linte celularin të pa karikuar.

Inspektori i policisë i ngarkuar për të komunikuar me të, mbajti shënim gjithçka, pastaj ndërpreu telefonatën dhe i raportoi Sallës Operative. Teksa Sajmir Lika zbriste me vrap shkallët e pallatit të tij në Berat, për t'i hipur makinës dhe nisur drejt Tiranës, patrulla e policisë mori urdhrin për të hapur derën me forcë dhe, për këtë arsye, kërkoi mbështetjen e Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Në orën dhjetë e pesë minuta, ekipi i zjarrfikësve hapi derën e apartamentit ku banonte shtetasja Luljeta Lika dhe dy inspektorët e policisë, Agron Bajraktari dhe Migena Mane hynë brenda, duke i hapur rrugë, zyrtarisht, tmerrit që do të mbërthente kryeqytetin dhe tërë vendin përgjatë ditëve në vijim.

--- LEXIMI PARAPRAK MBARON KËTU ----





Rezervo që tani kopjen tënde me -30%.  
Paguaj kur ta marrësh.

KLKO KËTU

OSE SKANO:



Ofertë e kufizuar deri ditën e botimit të librit.

## LIBRA TË TJERË NGA AUTORI

### Ndonjëherë qëndrojnë përgjithmonë

*Përmbledhje me tregime*

Botues: Botimet Dudaj  
Viti: 2019  
ISBN: 978-99943-0-605-3  
Faqe: 448  
Çmimi: 800 Lekë



Çdo 8 vjet historitë e frikshme përsëriten.

Pas përmbledhjeve "Fytyra tjetër e natës" (2003) dhe "Libri i bardhë" (2011), vjen kjo përmbledhje e re me tregime, që përmes fantastikes, misterit dhe tmerrit, na shpion në përumbje të reja, të panjohura dhe të frikshme, brenda një realiteti të ndërtuar buzë ankthesh, ku marrin formë turbullimet, impulset dhe çmenduritë që popullojnë botën brenda dhe jashtë secilit prej nesh.

Një masë e panjohur, e aftë për të gllabëruar jetë, një guaskë e mallkuar që ndjell vdekje, qenie të pabesueshme dhe shpirtra të grisur nga mizori të egra, që enden nëpër humnera absurde pa rrugëdalje, por edhe atmosfera të qeta, që papritmas shpërthejnë, duke na vënë para asaj forme të veçantë të tmerrit, që vetëm e pakuptueshmja mund ta ngjallë.

Tregim pas tregimi, ndërsa frika rrjedh para syve në forma të pa imagjinuara, do e gjejmë veten në një dimension marramendës, krejt pezull në një tension të vazhdueshëm midis dëshirës për të gjetur kurajë në errësirë dhe kthyer faqen ??tjetër dhe dëshirës për të vrapuar dhe dalë në dritë.

A thua se në dritë, gjërat shkojnë më mirë!

Përmbajtja:


1. KËTË HERË MË QUAJNË EMI
2. UJKU
3. GUASKA
4. RIPARUESI
5. KËRCIMI I PARË
6. MAMIA
7. NJË VAJZË DHE NJË DJALË
8. NA LËR TË SHKOJMË
9. GJIMNAZISTËT E SËMURË
10. GRUAJA E 8 MARSIT
11. MAKTH
12. VDEKJA ËSHTË ZANATI IM
13. DIÇKA ATJE JASHTË
14. DERA
15. MUA
16. VAJZA ME PATERICA
17. DITA E FUNDIT

## LIBRA TË TJERË NGA AUTORI

### Ajo e errëta

Roman

Botues: Botimet Dudaj  
Viti: 2018  
ISBN: 978-99943-0-536  
Faqe: 316  
Çmimi: 700 Lekë



Çdo vend ka një shtëpi të braktisur dhe çdo shtëpi e braktisur ka historinë e saj. Në qoftë se ndokush e ka harruar këtë gjë, "Ajo e errëta" na e ndërmend sërish.

Ngjarjet zhvillohen në Stora - një fshat bregdetar pranë Sarandës, ku Lira, Alma dhe Oresti, fillojnë e rrëmojnë mes viteve të pluhurosura dhe hijeve të harruara të një shtëpie të braktisur, buzë detit, duke zbuluar se e historia e saj kërkon të përsëritet sërish. Dhe historia e shtëpisë së braktisur buzë detit është e trishtë, e dhimbshme dhe e mbushur me terror: përpara se të braktisej përfundimisht, ajo është djegur dy herë dhe, në secilën prej herëve, një fëmijë ka vdekur mes flakëve.

Por kjo - do të zbulojnë tre shokët - është vetëm njëra anë e historisë: ajo që dinë të gjithë. Ana tjetër e saj, është ajo e një bote të harruar e plot hije, që ekziston kudo, por nuk është askund dhe ku çdo gjë që ndodh, ndodh gjithmonë dhe përgjithmonë.

Njëkohësisht, këtë gjë do të zbulojë edhe shkrimtari Vilson Leka, kur mëson se gjithë sukcesi i është shenjuar nga një prezencë e errët, që e ka tërhequr, dalëngadalë, drejt shtëpisë së braktisur. Po çfarë është duke ndodhur? Përse historia është e destinuar që të përsëritet? Ka ardhur vallë koha që një çmim të paguhet?

Në garë me kohën, dikush duhet të zbulojë të vërtetën, përpara se të jetë tepër vonë.

Sepse diku, mbi një shtrat prej hijesh, të një bote, që aty është, por dhe nuk është, ajo e errëta hap sytë e saj prej zjarri.

## LIBRA TË TJERË NGA AUTORI

### Vendi diku midis

Roman

Botues: Botimet ADA  
Viti: 2014  
ISBN: 978-9928-4216-0-9  
Faqe: 274  
Çmimi: 800 Lekë



Tiranë. Mesnatën e krishtlindjes, i kthyer në shtëpi pas anulimit të një udhëtimi me familjen, që do të kishte qenë gjithçka përveçse i këndshëm, Sidriti takohet me Anën magjepse dhe të mistershme. "Në qoftë se i plotëson të gjitha dëshirat, vdes", i mëson ajo, duke i treguar rrugën dhe hapur derën e një bote të pabesueshme dëshirash. Nën magjinë e tyre Sidriti dhe Ana e gjejnë veten në një aventurë urbane, mes fëmijësh të humbur, aksidentesh të dyshimta e fantazmash të një shoqërie të trembur, kriminele e të korruptuar... në një histori të errët familjare dhe dashurish të penguar, që do të ndryshojnë zemrën e Sidritit përgjithmonë.

Në garë me kohën, dikush duhet të zbulojë të vërtetën, përpara se të jetë tepër vonë.

Sepse diku, mbi një shtrat prej hijesh, të një bote, që aty është, por dhe nuk është, ajo e errëta hap sytë e saj prej zjarri.


## LIBRA TË TJERË NGA AUTORI

### Libri i bardhë

Përmbledhje me tregime

libri i  
bardhë

Botues: Bota Shqiptare  
Viti: 2011  
ISBN: 9789928000  
Faqe: 242  
Çmimi: 600 Lekë



Dikush zbulon një jetë tjetër, ose diçka të ngjashme me të... dikujt, ëndrra refuzon t'i përfundojë... dhe cila është dhurata më e mirë për dikë që nuk dëshiron ta shohësh me sy?... po sikur ajo që shkruan të jetë e tmerrshme, por jo aq sa ajo që nuk shkruan?... keni rezervuar një takim me princin e natës, një leksion me nxënësen e djallit dhe do pushtoheni nga dëshira të errëta, do udhëtoni në një planet të largët dhe, pa dyshim, kur t'ju zërë nata, vendi ku do ndaloni për ta kaluar, do jetë më i fundit që do donit të kishit zgjedhur. Por asgjë nuk mbaron me kaq. Në qoftë se jeta do të ishte një libër i bardhë, më thuaj, çfarë do dëshiroje të shkruaje në të? Këto, edhe më shumë, në trembëdhjetë tregime të zeza, që rrëmbejnë, turbullojnë dhe lënë pa gjumë. Mos i lexoni!


Përmbajtja:

1. LIBRI I BARDHË
2. TAXI 5
3. MËNGJES
4. "MADE IN INDIA"
5. DORA E DJATHTË
6. PAKTI
7. ASFALT
8. MË E BUKURA VAJZË E SHKOLLËS
9. TY
10. GRUAJA E FOTOGRAFIT
11. TË NESËRMEN
12. PROVIMI I FUNDIT
13. HONI I NATËS

## LIBRA TË TJERË NGA AUTORI

Fytyra tjetër e natës  
*Përmbledhje me tregime*

Botues: Ombra GVG  
Redaktor: 2003  
Viti: 99927-870-8-2  
ISBN: 267  
Faqe: 600 Lekë  
Çmimi:



Cili shkon në një restorant dhe sheh se vera e kuqe është pak si shumë e kuqe; cili në diskotekë i vë syrin vajzës më të bukur; cili për të kaluar një fundjavë zgjedh dhomën e gabuar... mirëserdhët në bord, zonja dhe zotërinj. Përgatituni për një udhëtim në botën e 'një dere më tutje', në botën e errët të natës, të populluar prej shpirtrash të zymtë, pasione të etura dhe etje të pashtershme. Është e vërtetë që fati është i verbër, apo jemi ne që verbohemi prej tij?

Përmbajtja:

1. 339
2. ADHURUESI I FISHEKZJARREVE
3. KUR NJË FËMIJË KA URI, DUHET T' I JAPËSH PËR TË NGRËNË
4. NGRËNËSIT E FARAVE
5. STINA E SHTATË
6. LËNDINA E DËSHIRAVE
7. BËRË ME DORË
8. STUDENTORE
9. FYTYRA TJETËR E NATËS

**Maj**  
**2021**